



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DRITAN J. GJANA  
ADRESA NR.7, NIKOLLA JORGA,  
NR.1, NR.2, NR.1  
TEL: 0695813188

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 5255

Nr. koleksioni: 1623

Kamez më 08/12/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053160089096784



A2022053160089096784

## KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

( Të Shoqërisë “Legalmaster” Sh.P.K)

Sot, më datë 08.12.2022, para meje Noter DRITAN J. GJANA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. NIKOLLA JORGA, NR.1, NR.2, u paraqit personalisht:

### SHITES:

**Blerina Qazimi**, atësia Abas, amësia Ilirjana, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në TIRANË, me adresë Ymer Kurti; Nd. 8; H. 3; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 21/08/1982, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 031939068 dhe nr. personal I25821045K.

### BLERES:

**Edisa Theodhori**, atësia Andrea, amësia Zhaneta, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banuese në KORÇË, me adresë Minir Mustafaj 02330193; Nd. 14; H. 2; Ap. 3; Korçë; Korçë; 7004; Korçë, lindur më 19/02/1990, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037465045 dhe nr. personal J05219076K.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Legalmaster” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

### Hyrje

Në datën 31.01.2017, është regjistruar shoqëria “Legalmaster” SHPK, NR. NUIS L71331028J, person juridik shqiptar me objekt “Keshillime ligjore per personat fizike a juridike, vendas a te huaj ne te gjitha fushat e se drejtes, perfshire ketu edhe hartimin e cdo dokumentacioni ligjor perfshire ketu edhe hartimin e kontratave.....”, me administrator Edisa Theodhori dhe ortak të vetëm Blerina Qazimi, me kapital themeltar 100.000 lekë.

Me vendimin e ortakut të vetëm, është miratuar shitja e një kuote që përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë “Legalmaster” SHPK në favor të znj. Edisa Theodhori.

Në këto kushte, personat e mësipërm duke qënë madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnet të lirë e të plotë, përpilojnë hartimin e kësaj kontratë shitje kuotash, me tekstin e mëposhtëm:

Fq. 1



A2022053160089096784

## BAZA LIGJORE

Baza juridike e lidhjes së kësaj kontrate janë nenet 72, 73, 74 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nenet 6, nenet 84-90, 705-756 të Kodit Civil, Ligji Nr. 26/2019 si edhe vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Legalmaster" SHPK znj. Blerina Qazimi të datës 02.06.2022 për kalimin e një kuote të shoqërisë "Legalmaster" shpk e cila përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë "Legalmaster" SHPK në favor të znj. Edisa THEODHORI.

### NENI 1

#### OBJEKTI I KONTRATËS

Shitësi angazhohet ti shesë Blerësit një kuotë që përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë "Legalmaster" SHPK, të lira nga cdo barrë dhe Blerësi angazhohet që do të blejë këtë pjesë që përfaqëson 35% të kapitalit të shoqërisë "Legalmaster" SHPK duke plotësuar pagimin e cmimit sipas kësaj kontrate.

### NENI 2

#### CMIMI I KONTRATËS

**Cmimi i shitjes së një kuote që përfaqëson 35% te kapitalit të shoqërisë "Legalmaster" SHPK në favor të znj. Edisa THEODHORI është 35,000 lekë, i llogaritur si përqindje e kapitalit të regjistruar dhe të nënshkruar të shoqërisë Legalmaster shpk, cmim i cili do të likujdohet në llogarinë bankare të Znj. Blerina Qazimi.**

### NENI 3

#### FITIMI I PRONËSISË SË KUOTËS

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi fiton pronësinë e një kuotë në kapitalin e shoqërisë "Legalmaster" SHPK në vlerën 35% të kapitalit të kësaj shoqërie, ndersa znj. Blerina Qazimi do të ketë një kuotë në vlerën 65% të kapitalit të kësaj shoqërie.

Palët kontraktore pranojnë se me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi heq dorë nga pronësia e pjesëve të shitura të kapitalit dhe nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me objektin e kësaj kontrate dhe se pas realizimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në QKB, blerësi znj. Edisa Theodhori bëhet pronare e ligjshme të një kuote me vlerë 35% të kapitalit të shoqërisë "Legalmaster" SHPK.

**Shoqëria « Legalmaster » shpk, në vijim të kësaj kontrate do të ketë këtë konfigurim pronësie :**

**-znj. Blerina Qazimi pronare e 1 (një) kuote që përfaqëson 65 % të kapitalit të shoqërisë « Legalmaster » shpk**

**-znj. Edisa Theodhori, pronare e 1 (një) kuote që përfaqëson 35 % të kapitalit të shoqërisë « Legalmaster » shpk**

### NENI 4

Fq. 2





A2022053160089096784

## DOKUMENTACIONI DHE HARTIMI I KONTRATËS

Kësaj Kontrate i bashkëlidhen:

- Vendimi i Asamblese së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) të shoqërisë "Legalmaster" SHPK, datë 02.06.2022

### NENI 5

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

5.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

5.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

5.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

#### PALËT KONTRAKTUESE

##### SHITES

**Blerina Qazimi**

*Blerina Qazimi*

##### BLERES

**Edisa Theodhori**

*Edisa Theodhori*

**Noter  
DRITAN J. GJANA**





“Legalmaster” Shpk

NIPT L71331028J

Rruga “Abdi Toptani”, Business & Residence Torre Drin, Ap.113, Kati 11, Tiranë

Date 02.06.2022

## VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË “LEGALMASTER” SHPK

Sot më datë 02.06.2022 u mbledh Asambleja e Ortakëve të shoqërisë “LEGALMASTER” SHPK - me ortak të vetëm znj. Blerina Qazimi, zoteruese e një kuotë që përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, në selinë e Shoqërisë me adresë Rruga “Abdi Toptani”, Business and Residence Torre Drin, kati 11, e cila,

### VENDOSI

- a) Miratimin e shitjes së një kuote që përben 35% pjesë të kapitalit të shoqërisë tek blerësi znj. Edisa Theodhori, lindur në Korçë, në datën 19.02.1990, me Nr. Personal J05219076K, kundrejt cmimit të referuar sipas kapitalit të regjistruar prej 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) Lekë.
- b) Në referencë të pikës (a) të këtij vendimi, vendosi nënshkrimin e kontratës së kalimit të kuotës pranë zyrës noteriale.
- c) Pas nënshkrimit të kontratës, konfigurimi i pronësisë së shoqërisë “Legalmaster” shpk do jetë si më poshtë mes ortakëve:
  - znj. Edisa Theodhori, zotëruese e një kuote që përbën 35 % të kapitalit të shoqërisë “Legalmaster” shpk
  - znj. Blerina Qazimi, zotëruese e një kuote që përbën 65 % të kapitalit të shoqërisë “Legalmaster” shpk

d) Pasqyrimin e këtij ndryshimi tek Qendra Kombëtare e Bizneseve në përputhje me kërkesat e nenit 35, të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

**ORTAKU I VETEM**

**I SHOQERISE "LEGALMASTER" SHPK**



znj. Blerina Qazimi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Blerina Qazimi".

Blerina Qazimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71331028J
2. Data e Regjistrimit	31/01/2017
3. Emri i Subjektit	Legalmaster
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	18/01/2017
6. Kohëzgjatja	Nga: 18/01/2017
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Abdi Toptani", Business & Residence Torre Drin, Ap. 113, kati 11
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Keshillime ligjore per personat fizike a juridike, vendas a te huaj ne te gjitha fushat e se drejtes, perfshire ketu edhe hartimin e cdo dokumentacioni ligjor perfshire ketu edhe hartimin e kontratave; Perfaqesimin e personave fizike a juridike, vendas a te huaj ne te gjitha gjykatat e cdo lloji dhe te te gjitha shkalleve ne teritorrin e Republikes se Shqiperise; Te marre pjese ne projekte qe kane si qellim njohjen dhe implementimin e legjislacionit nderkombetar e vecanerisht atij te BE ne legjislacionin e brendshem ne kuadrin e procesit te integritimit euroatlantik te vendit; Te marre pjese ne projekte qe kane si qellim zbatimin e legjislacionit ne fuqi, si dhe te ndihmoje nepermjet trajnimeve juriste dhe eksperte te fushave perkatese ne njohjen, interpretimin dhe zbatimin e akteve normative; ne permiresimin e legjislacionit ne pergjithesi, dhe atij te organizimit e funksionimit te institucioneve te sistemit te drejtesise ne vecanti; Te ndihmoje subjektet e biznesit ne zgjidhjen e mosmarrveshjeve me pajtim, duke bere te njohura edhe praktikat nderkombetare te arbitrazhit, per zgjidhjen e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	konflikteve tregtare.	
10. Administratori/ët	Edisa Theodhori	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 18/01/2022	Deri: 18/01/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	BlerinaQazimi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komentë (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Legalmaster E-Mail: gatlegalconsuling@gmail.com edisa_theodhori@hotmail.com Telefon: 0696244588	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 08/12/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga  
Qendra Kombëtare e Biznesit  
Date:2022/12/08 13:10:23 +01:00  
L71331028J2022120813101369  
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)



**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-2022120716555772  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 07.12.2022  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 4:55:57PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-445-5394  
Referenca e Perdoruesit:



**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

BLERINA ABAS QAZIMI  
LEGALMASTER SH.P.K.



*Atensi's - gdm*